



**PROCES VERBAL I ASAMBLESE SE AKSIONEREVE TE
SHOQERISE TREGTARE "A&H&V POWER" Sh.p.k**

Sot ne date 21.09.2019 ne prezence time noter Alket Z. Mancka u mbajt mbledhja e aksionereve te SHOQERISE TREGTARE "A&H&V POWER" Sh.p.k te pranishem si me poshte

Une noteri konform Ligjit 110/2018 "PËR NOTERINË" më posaçërisht **Neni 62 – "Kompetencat e noterit"**, gërmat k dhe l, "*harton procesverbalin*" dhe "*përpilon dhe merr pjesë aktive në hartimin e akteve të shoqërive tregtare*".

1. **Shoqëria "AV International Group" sh.a (ish- "A&V-GAS")**, zotëruese e 55,00 të pjesëve të kapitalit në Shoqërinë "A&H&V POWER" Sh.p.k. ose ndryshe i 55% te kapitalit te shoqerise. E përfaqësuar nga me Vendim te Aksionerit te shoqerise NR 144 Prot. Date 27.08.2019 nga Z.Fredi Gjergji, lindur me 14.12.1975, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit numer 07471427 dhe numer personal H51214056M,

Zoterues i 55 (pesëdhjete e pese) pjesëve, ose ndryshe i 55% te kapitalit te shoqerise

2. **Hertis KAPIDANI**, zotërues i 22,50 të pjesëve të kapitalit në Shoqërinë "A&H&V POWER" Sh.p.k., ose ndryshe i 22,50 % te kapitalit te shoqerise.

Në mbledhje mungon ortaku:

3. **Shoqëria "CARAGLIO" srl**, zotërues i 22,50 të pjesëve të kapitalit në Shoqërinë "A&H&V POWER" Sh.p.k. ose ndryshe i 22,50 % te kapitalit te shoqerise.

Mbledhja hapet nga administratori i shoqërisë Z. Hertis KAPIDANI mbas 30 minutash nga percaktimi i ores 11.00 ne pritje te aksionerit Shoqerise "CARAGLIO" srl. Mbledhja filloi ne ne oren 11.30.

Aksioneret prezent te cituar si me siper diskutuan rendin e dites dhe rane dakort sipas pikave te percaktuara

Ne presence time aksioneret nenshkruan dhe procesverbalin pa kundërshime

Shoqëria "AV International Group" sh.a (ish- "A&V-GAS")

Përfaqësuar nga
Fredy Gjergji



Hertis KAPIDANI

Hertis Kapidani



NOTER
ALKET Z. MANÇKA



SHOQERIA TREGTARE "A&H&V POWER" Sh.p.k.

NUIS: L23028203L

Zyra qendrore: Elbasan, Elbasan, ELBASAN, Lagja Kala, Rruga Spiro Gjini, nr.24

Nr. 4 Protokolli

Elbasan me 02/09/2019

**VENDIM
I ASAMBLESE SE ORTAKEVE**

Sot, me date 02.09.2019 (dymije e nëntëmbëdhjete), ne seline e Shoqërisë Tregtare "A&H&V POWER" Sh.p.k., mbledhet Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë.

Në mbledhje marim pjesë ortaket:

1. **Shoqëria "AV International Group" sh.a (ish- "A&V-GAS")**, zotëruese e 55,00 të pjesëve të kapitalit në Shoqërinë "A&H&V POWER" Sh.p.k. ose ndryshe i 55% të kapitalit të shoqërisë.
E përfaqësuar nga me Vendim të Aksionerit të shoqërisë NR 144 Prot. Date 27.08.2019 nga Z.Fredi Gjergji, lindur me 14.12.1975, madhor me zotesi të plote juridike për të vepruar, mbajtes i leternjoftimit numer 07471427 dhe numer personal H51214056M,
Zoterues i 55 (pesëdhjete e pese) pjesëve, ose ndryshe i 55% të kapitalit të shoqërisë
2. **Hertis KAPIDANI**, zotërues i 22,50 të pjesëve të kapitalit në Shoqërinë "A&H&V POWER" Sh.p.k., ose ndryshe i 22,50 % të kapitalit të shoqërisë.

Bashkarisht, ortakët sipër përshkruar zotërojnë 77,5% (shtatëdhjet e shtatë pjesje pesë për qind) të kapitalit të shoqërisë.

Në mbledhje mungon ortaku:

3. **Shoqëria "CARAGLIO" srl**, zotërues i 22,50 të pjesëve të kapitalit në Shoqërinë "A&H&V POWER" Sh.p.k. ose ndryshe i 22,50 % të kapitalit të shoqërisë.

Mbledhja hapet nga administratori i shoqërisë Z. Hertis KAPIDANI mbas 30 minutash nga percaktimi i ores 11.00 ne pritje të aksionerit Shoqërisë "CARAGLIO" srl. Mbledhja filloi ne ne oren 11.30.

Ne mbledhje është ftuar të marrë pjesë Noter Alket Z. Mançka i cili konform Ligjit 110/2018 "PËR NOTERINË" më posaçërisht **Neni 62 – "Kompetencat e noterit"**, gërmat k dhe l, "*harton procesverbalin*" dhe "*përpilon dhe merr pjesë aktive në hartimin e akteve të shoqërive tregtare*".

Ortakët vendosin që drejtimi i mbledhjes të kryhet nga ortaku, Hertis KAPIDANI, ndërsa proces verbali i mbledhjes mbahet nga noteri.

Ortakët evidentojnë se:

Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë, në këtë mbledhje e përbërë nga ortakët Shoqëria "**AV International Group" sh.a (ish- "A&V-GAS")** dhe Hertis KAPIDANI evidentojnë se:

- 1- Mbledhja e shoqërisë është e thirrur e vijon konform kërkesave të Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe Statutit të shoqërisë "A&H&V POWER" Sh.p.k,

- 2- Mbledhja e shoqërisë është e thirrur nëpërmjet aktit "NJOFTIM", Nr. Protokoll 1, datë 15.08.2019. Në njoftim, në zbatim të ligjit, konform afateve dhe procedurës së parashikuar me ligj është evidentuar koha, vëndi i mbledhjes si edhe rendi i ditës.
- 3- Ortaket janë njoftuar rregullisht dhe e kanë marrë njoftimin e derguar.
- 4- Njoftimi i Ortakëve Shoqëria "**AV International Group**" sh.a (ish- "A&V-GAS") dhe Hertis KAPIDANI deklarohet personalisht ne mbledhje.
- 5- Njoftimi i rregullt i Ortakut: Shoqëria "CARAGLIO" srl, evidentohet nëpërmjet praktikës së njoftimit me postë të regjistruar me kthim pergjigjje, vertetuar me Vërtetimin e Njesisë më Originalin Nr. 3475 datë 30.08.2019. (noter Alket Mançka)

Në evidentim të sa më sipër ortaket prezent në mbledhje, zotërues të 77,50% (shtatëdhjet e shtatë presje pesëdhjet për qind) të kapitalit të shoqërisë vlerësojnë se:

- Njoftimi për mbledhje është kryer konform ligjit dhe statutit;
- Statuti i shoqërisë "**AV International Group**" sh.a (ish- "A&V-GAS"), përkatësisht NENI 18 i tij përcakton se asambleja e ortakeve mund te marrë vendime te vlefshme qofte edhe për ndryshime në statut nëse aprovohet nga ortakët zotërues të 3/4 (tre të katërtave) të kapitalit total të shoqërisë.
- Ortakët prezent, 1-Shoqëria "**AV International Group**" sh.a (ish- "A&V-GAS") dhe 2-Hertis KAPIDANI, bashkërisht zotërojnë 77,50% të kapitalit të shoqërisë pra më tepër se kërkesa prej 3/4 = 75% të kapitalit.

Përfundimisht Asambleja e Ortakëve te Shoqërisë vlerësojnë se egziston kuorumi i nevojshem për të marrë vendim të vlefshëm dhe vijojnë diskutimin.

Asambleja e Ortakëve te Shoqërisë diskutojnë dhe vendosur mbi kete:

REND DITE:

- Zvogelimin e kapitalit të shoqërisë "A&H&V POWER" Sh.p.k.;
- Shlyerja e taksave dhe detyrimeve fiskale;
- Korrigjimi i kapitalit të shoqërisë.
- Shqyrtimi i kërkesës / mundësisë për shitje / transaksion të pjesëve të kapitalit brenda shoqërisë dhe ose tek të tretët.
- Të ndryshme

Asambleja e Ortakëve te Shoqërisë evidenton faktin se

Kapitali i deklaruar i shoqërisë "A&H&V POWER" sh.p.k. prej themelimit të saj e deri më sot, i deklaruar 162.476.500,00 LEK nuk është kapitali faktik i shoqërisë.

Vlera e barabartë me 162.476.500,00 LEK nuk është derdhur asnjëherë si Kapitali i shoqërisë "A&H&V POWER" sh.p.k. Asnjë prej ortakëve nuk ka derdhur propocionalisht pjesë të këtij kapitali.

Shoqëria faktikisht nuk e ka zotëruar dhe nuk e zotëron këtë kapital themeltar për pasojë shënimi se Kapitali i shoqërisë "A&H&V POWER" sh.p.k. i barabarte me 162.476.500,00 LEK është rregjistrim i pavërtetë.

Ortakët nuk janë në gjendje dhe nuk sipërmarrin te përmbushin një deklaram të tillë.

Asambleja e Ortakëve te Shoqërisë vlerëson se kapitali i deklaruar, i barabartë me 162.476.500,00 paraqet një të dhënë të pa vërtetë.

Asambleja e Ortakëve te Shoqërisë vlerëson detyrimin e shoqërisë për të deklaruar të dhëna të verteta dhe,

ASAMBLEJA E ORTAKËVE TE SHOQËRISË



VENDOS

- I. Të ndryshohet / korrigojohet kapitali i deklaruar themelor i shoqërisë.
- II. Kapitali i deklaruar themelor i shoqërisë:
ISHTE: All 162.476.500,00 (njëqind e gjashtëdhjet e dy milion e katërqind e shtatëdhjet e gjashtë mijë e pesëqind lek).
BËHET: ALL 100 000,00 (njëqind mijë lek).
- III. Numri i përgjithshëm i kuotave / pjesëve të shoqërisë:
ISHTE: 100,00 (njëqind) kuota / pjesë
BËHET: 3,00 (tre) kuota / pjesë
- IV. Kapitali i shoqërisë vijon të zotërohen bashkërisht dhe ne proporcione të pa ndryshuara nga ortakët si vijon:
 1. **Shoqëria "AV International Group" sh.a (ish- "A&V-GAS")**
Numri i pjesëve në zotërim: **1 (një) pjesë**
Vlera e kapitalit të zotëruar: **55 000,00** (pesëdhjet e pesë mijë Lek).
 2. **Shoqëria "CARAGLIO" srl,**
Numri i pjesëve në zotërim: **1 (një) pjesë**
Vlera e kapitalit të zotëruar: **22 500,00** (njëzet e dy mijë e pesë qind Lek).
 3. **Hertis KAPIDANI,**
Numri i pjesëve në zotërim: **1 (një) pjesë**
Vlera e kapitalit të zotëruar: **22 500,00** (njëzet e dy mijë e pesë qind lek).
- V. Ngarkohet Administratori i shoqërisë, Hertis KAPIDANI, që personalisht apo edhe nëpërmjet një personi të autorizuar prej tij të depozitojë këtë vendim pranë QKB dhe të ndjekë procedurat e nevojshme për korigjimin e kapitalit.

ASAMBLEJA E ORTAKËVE TE SHOQERISE

Shoqëria "AV International Group" sh.a (ish- "A&V-GAS")

Përfaqësuar nga
Fredri Gjergji




Hertis KAPIDANI

Hertis Kapidani

NOTER
Alket Z. Mançka





NR. 144 PROT

DATE: 27.08.2019

VENDIM NR. ____
AKSIONERIT TE VETEM TE SHOQERISE
"AV INTERNATIONAL GROUP" SHA

Sot me date 27.08.2019, pranë selisë ligjore të shoqërisë "AV International Group" Sha.(AVIG) në Durrës, në prani të Aksionerit të vetëm të shoqërisë :

Z. Piro Bare

Zhvillohet mbledhja me rendin e ditës:

RENDI I DITES:

1. Autorizim pjesëmarrjen në mbledhjen e ortakeve të shoqërisë A&H&V Power Shpk;
2. Autorizim për nënshkrim vendimi
3. Etj

Aksioneri i vetëm i shoqërisë, pas diskutimeve dhe konsultimeve bazuar në Ligjin nr.9901 dt.14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe Statutit të Shoqërisë.

VENDOSËN:

1. Autorizohet Z Fredi Gjergji, që në emër dhe për llogari të shoqërisë "AV International Group" Sha të jetë pjesëmarrës dhe përfaqësues me kompetencë të plotë për shoqërinë AVIG, në mbledhjen e ortakeve të shoqërisë A&H&V Power Shpk me datë 02.09.2019 ora 11:00;
2. Përfaqësuesi i shoqërisë Z. Fredi Gjergji, do të paraqesë vendimin "PRO" dhe do të nënshkruaj në emër dhe në interes të shoqërisë AVIG, vendimin e ortakeve të shoqërisë A&H&V Power Shpk për zvogëlimin e kapitalit të kësaj shoqërie;
3. Përfaqësuesi i shoqërisë në mbledhje do të paraqesë pretendimet e shoqërisë AVIG dhe në çdo rast do të mbroj interesat legjitime të shoqërisë AVIG si ortake e shoqërisë A&H&V Power Shpk;
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

AKSIONERI I SHOQERISE
"AV INTERNATIONAL GROUP" SHA.
PIRO BARE



AV INTERNATIONAL GROUP sha NIPT: K922235030

Adresa: 700 m Veri të Hidrovorit, PORTO ROMANO, DURRES – ALBANIA

Kontakt: Tel/Fax: +355 52 250 013 E-mail: office@avgas.al

www.avgas.al